

QENDRA KOMBËTARE
E BIZNESIT
Nr. 4072 Prot.
Datë 15.3.2019



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË



Nr 485/8 Prot

Nr 485 Dosje



SHËRBIMI PËRMBARIMOR
GJYQËSOR PRIVAT
Tiranë, më 13.03.2019

VENDIM

PËR PUSHIMIN E EKZEKUTIMIT

Unë, Haxhi Ismaili, me detyrën e Përmbarsuesit Gjyqësor, pranë Shoqërisë së Përmbarsimit Privat "3H" SHPK, në referim të **Urdhërit të Ekzekutimit** Nr. 578 date 20.11.2018 të lëshuar prej Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, kam vënë në ekzekutim këtë *urdhër*, duke regjistruar në dosjen përmbarsimore Nr.485 date 18.02.2019 kërkesën e **Kreditorit**- Dega e Doganes Durrës për vënie në ekzekutim **të titullit ekzekutiv**, Vendimi për rikuperim me force të borxhit doganor me Nr. 10792 date 09.07.2018 të Degës Doganes Durrës, për **Debitorin** – **Green Fuel sha me NIPT L11813503T e administrator Z. Ilmir Abazi**.

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke i dërguar debitorit **Green Fuel sha me NIPT L11813503T e administrator Z. Ilmir Abazi** Lajmërimin Nr. 485/1 Prot, Datë 18.02.2019 për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin, kam kaluar në vënie sekuestrosh konservative tek pasuritë e tij, pasi konstatova se nuk respektuan afatin e këtij lajmërimi vendosa;

Urdhër për vendosjen e sekuestros konservative është dërguar në:

- 14 – Bankat Tregtare, me shkresën Nr. 485/5 Prot. Datë 11.03.2019
- Drejtoria Rajonale e Transportit Rrugor Tirane, me shkresën Nr.485/6 Prot date 11.03.2019
- Qendra Kombetare e Biznesit, me shkresën Nr.485/7 Prot date 11.03.2019

Lidhur sa më sipër, duke zhvilluar dhe kryer veprimet procedurale të nevojshme për ekzekutimin e plotë të titullit ekzekutiv me palët e lartpërmendura,

KONSTATOJ

Se më datë 13.03.2019 debitori ka likujduar totalisht detyrimin si dhe tarifen përmbarsimore të Shoqërisë 3H shpk, pranë Bankës Kombetare Tregtare sipas Urdhërit të Ekzekutimit Nr. 578 date 20.11.2018 të lëshuar prej Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

Sa më sipër në mbështetje të nenit 616 gërma "a" e 617 të K.Pr.Civil, dhe Ligjit Nr.10031 dt.11.12.2008 "Për Shërbimin Përmbarsimor Gjyqësor Privat",

VENDOSA

1. Pushimin e ekzekutimit të Urdhrit të Ekzekutimit Nr. 578 date 20.11.2018 te Gjykares Administrative te Shkalles se Pare Durres pasi është përmbushur detyrimi ndaj kreditorit.
2. Ky vendim ti njoftohet menjëherë debitorit, kreditorit si edhe të gjitha institucioneve apo organeve shtetërore apo private të treguara në pjesën arsyetuese të vendimit (a,b,c), të cilat pasi vendimi merr formë të prerë, me marrjen dijeni, **duhet të zhblllokojnë menjëherë nga sekuestro konservative pronat e luajtshme apo të paluajtshme, së bashku me depozitat, kreditë apo llogaritë bankare të debitorit Green Fuel sha me NIPT L11813503T e administrator Z. Ilmir Abazi.**
3. Një kopje e vendimit të pushimit t'i dorëzohet zyrës së financës këtu, për të kryerë veprimet përkatëse në lidhje me dosjen përbarimore.
4. Ky vendim mund të ankimohet përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, brenda 5-ditësh nga marrja dijeni.

**SHOQËRIA E PËRMBARIMIT PRIVAT "3 H" SHPK
PERMBARUES GJYQESOR**

Haxhi ISMAILI

